



Nr. 5659 Prot

03.11.2023

MINISTRI  
UDHËZIM

Nr. 694, datë 03.11.2023

PËR  
**PROCEDURAT E PËRDITËSIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE DHE  
ADMINISTRIMIN E PASURITË KULTURORE TË VJEDHURA**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 6 të nenit 130, shkronjës “r” të nenit 268 të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”

**UDHËZOJ:**

**I. RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRDITËSIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE**

1. Ky udhëzim përcakton rregullat dhe procedurat në lidhje me përditësimin e Bazës së të Dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura” (në vijim referuar si *Baza e të Dhënave*), të paraqitura në bazën e të dhënave, të cilat janë në ruajtje nga autoritetet përgjegjëse, deri në momentin që ju kthehen pronarëve të ligjshëm apo përfaqësuesve të tyre, në përputhje me pikën 6 të nenit 130 të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.
2. Baza e të dhënave krijohet nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) në përputhje me dispozitat e nenit 130 të ligjit nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 583, datë 6.10.2021 “*Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë*”.

**II. PËRKUFIZIME**

Për qëllimet e këtij udhëzimi termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- “Baza e të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura” është mbledhja/grumbullimi i organizuar i informacionit lidhur me pasuritë kulturore të luajtshme të vjedhura, të hyra ose të dala në mënyrë të paligjshme dhe/ose trafikuar, në ose brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të ruajtur në formë elektronike, ku përpunimi dhe përditësimi i tij, kryhet nëpërmjet një sistemi kompjuterik, sipas parashikimeve të nenit 130 të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi;
- “Administrim i bazës së të dhënave” është menaxhimi i bazës së të dhënave, që përfshin të gjithë profilet e hyrjes në sistemin e Bazës së të Dhënave, në veçanti përditësimin dhe ndryshimin e informacionit të ruajtur në të;
- “Institucioni administrues” është IKRTK, i cili është përgjegjës për administrimin e bazës së të dhënave në përputhje me ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, VKM nr. 583, datë 6.10.2021 “Për krijimin e bazës së të dhënave për pasurinë kulturore të vjedhura” dhe këtë udhëzim;
- “Dhënësit e informacionit” janë subjektet publike, private ose ndërkomëtare, siç përcaktohet në pikën 3 të nenit 130 të ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, VKM nr. 583, datë 6.10.2021 “Për procedurat e krijimit dhe administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë”, dhe këtë Udhëzim, për të siguruar informacione në Bazën e të Dhënave, përkatësisht: IKRTK, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe institucionet në varësi të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe institucionet në varësi të saj, njësitat e vetëqeverisjes vendore, institucionet publike kombëtare që kanë në pronësi dhe administrojnë fonde të pasurive kulturore, bashkësítë fetare dhe organizmat ndërkomëtarë që operojnë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që kanë në fushën e veprimtarisë së tyre edhe trashëgiminë kulturore;
- “Ndërveprimi” është procesi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet bazave të të dhënave.

### III. ADMINISTRIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE

- Baza e të dhënave administrohet nën përgjegjësinë e Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, i cili është “institucioni administrues”, me të drejtën eksklusive të të gjitha profileve të hyrjes në sistem, veçanërisht përditësimin dhe ndryshimin e informacionit të ruajtur në të.
- Nëpërmjet zyrave të saj, IKRTK është përgjegjëse për:
  - sigurimin korrekt dhe përditësimin përkatës të të dhënave, si dhe zhvillimin e sistemit kompjuterik në përputhje me standardet ndërkomëtare;
  - sigurimin e një qarkullimi të përshtatshëm të informacionit, në bazën e të dhënave të INTERPOL-it, për pasuritë kulturore që rezultojnë të vjedhura.

### IV. MËNYRAT E PËRDITËSIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Përditësimi i bazës së të dhënave kryhet nga IKRTK si organ administrues me autoritetin për të ndryshuar informacionin në të.
2. Informacioni që përbën bazën për ndryshimin e bazës së të dhënave sigurohet nga IKRTK, ose nga dhënësit e informacionit, ose institucionë ndërkombëtare, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore, siç përcaktohet në VKM nr.583/2021 “Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë”.
3. Një objekt i pasurisë kulturore i renditur në Bazën e të Dhënave, hiqet prej saj nga IKRTK në rastet kur paraqitet një kërkesë e institucioneve publike ose në vijim të dorëzimit vullnetar, nga ana e subjekteve që posedojnë pasuri të përfshira në këtë Bazë të të dhënave. Poseduesi, i cili dorëzon pasurinë kulturore mund të mbetet anonim vetëm nëse ai/ajo e dorëzon objektin brenda 3 (tre) viteve nga momenti i renditjes së objektit në bazën e të dhënave, përndryshe duhet të deklarojë të dhënat personale.
4. Procedura për dorëzimin vullnetar të pasurisë kulturore, të renditur në Bazën e të dhënave kryhet në përputhje dispozitat e Kreut XIII të këtij Udhëzimi.

## V. MËNYRA E PASURIMIT ME TË DHËNA NGA DHËNËSIT E INFORMACIONIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, institucionet në varësi si edhe çdo agjenci tjetër e zbatimit të ligjit, janë të detyruara të pasurojnë Bazën e të Dhënave, në mënyrat dhe përcaktimet e parashikuara më poshtë, nga momenti i marrjes së njoftimit për veprën penale të kryer në lidhje me vjedhjen e pasurisë kulturore apo trafikimin e paligjshëm të saj dhe deri në rikuperimin e saj, duke përfshirë dhe pasurinë/pasuritë kulturore, që i përkasin vetëm institucioneve publike, të pakthyera nga dalja e përkohshme e tyre apo të hyra në mënyrë të paligjshme.
2. Rikuperimi i pasurisë kulturore që është përfshirë në Bazën e të Dhënave, konsiderohen si rastet e dorëzimit vullnetar nga poseduesi në polici ose nga agjenci të tjera të zbatimit të ligjit si edhe rastet e konfiskimit të pasurive të tillë nga agjenci ligjzbatusë. Informacioni mbi rikuperimin në fjalë do të sjellë si rezultat, heqjen e pasurisë kulturore të rikuperuar nga Baza e të Dhënave.
3. Të dhënat që do të komunikohen nga autoritetet e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu paraqiten sipas Shtojcës “A” (seksionet “A” dhe “B”) të VKM-së 583/2021 “Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë” dhe përfshijnë elementet e identifikimit si më poshtë:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duhet të përfshijë:

### Të dhënat e ngjarjes

- i. kodi i ngjarjes/ numër reference;
- ii. zyra e cila ka marrë raportin e ngjarjes ose e raporton atë;
- iii. protokolli i zyrës proceduese;
- iv. referenca e bazës së të dhënave;
- v. data e aktit;

- vi. data e ngjarjes;
- vii. ankuesi;
- viii. vendi ku është kryer vepra penale;
- ix. qarku;
- x. bashkia;
- xi. njësia administrative;
- xii. adresa;
- xiii. Raportimin e ngjarjes ku ndodhi vjedhja, apo dalja apo hyrja e paligjshme e pasurisë kulturore;
- xiv. skeduesi;
- xv. data e skedimit;

b) Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (për objektet që janë të regjistruara në RPK) dhe përfshijnë:

**Të dhëna mbi objektin:**

- i. kodi i objektit;
- ii. lloji i objektit;
- iii. teknika;
- iv. materiali;
- v. gjatësia;
- vi. gjerësia;
- vii. lartësia;
- viii. diametri;
- ix. pesha;
- x. vlera;
- xi. periudha;
- xii. titulli;
- xiii. autor;
- xiv. numri i inventarit;
- xv. kodi RPK.

**Galeria e objektit:**

- i. dokumentacioni administrativ (urdhra, vendime);
- ii. dokumentacioni fotografik për objektet;
- iii. dokumentacioni audiovizual për objektet e trashëgimisë materiale ose jomateriale; iv. emërtimi;
- iv. madhësia;
- v. lloji;
- vi. pamja ballore.

**Statusi:**

- i. status autenciteti;
- ii. i humbur;
- iii. status dëmtimi;
- iv. trashëgimi;
- v. aprovuar;
- vi. miratuar;

**Historiku:**

- i. titulli;
- ii. historiku;
- iii. bibliografia.

**Përshkrime:**

- i. akademik;
- ii. përshkrimi;
- iii. të tjera.

Për pasuritë kulturore që i nënshtronen daljes apo hyrjes së paligjshme tek të dhënat që përfishijnë këto pasuri duhet të jenë edhe:

- i. numri i licencës së qarkullimit lirë apo të përkohshëm lëshuar nga IKRTK;
  - ii. vlerësimi ekonomik i dëmtimit të pasurisë së luajtshme (nëse është i mundur);
  - iii. elementët e mbulimit të sigurimit.
4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, institucionet në varësi, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij kreu, i komunikojnë IKRTK, me anë të komunikimit elektronik të dhënat e referuara sipas parashikimeve nën të njëtin nen, në lidhje me vjedhjen ose daljen ose hyrjen e paligjshme dhe/ose pasurinë kulturore të trafikuar, ose moskthimin e pasurive brenda afatit të paraqitur në licencën e qarkullimit të përkohshëm, dhe në çdo rast jo më vonë se 48 (dyzetë e tetë) orë nga momenti i marrjes në dijeni të kryerjes së veprës penale apo shkeljes në fjalë. Të gjitha të dhënat, që vendosen në dispozicion nga Policia e Shtetit dhe nga personeli doganor i strukturave hetimore, luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm dhe i strukturave të tjera doganore, që përcaktohen me ligj specifik, të cilat kanë atributet e Policisë Gjyqësore, sipas nenit 7, paragrafi 4 i Kodit Doganor, miratohen paraprakisht nga prokurori i çështjes.

Brenda 20 (njëzetë) ditësh, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, institucionet në varësi dhe çdo agjenci tjetër e zbatimit të ligjit, referuar parashikimeve në pikën 1 të këtij kreu, do t'i komunikojnë IKRTK, çdo ndryshim të të dhënavë që janë të nevojshme në vijim pas rikuperimit të pasurisë kulturore, duke plotësuar formularin sipas Shtojcës "B" të VKM 583/2021 "Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënavë të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë".

## **VI. FURNIZIMI ME INFORMACION NGA INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE**

1. Institucionet ndërkombëtare bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënavë, në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore, mund të sigurojnë informacione për IKRTK në lidhje me pasuritë kulturore që hyjnë ose dalin në mënyrë të paligjshme dhe/ose trafikohen brenda dhe jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë.

- IKRTK, nëpërmjet organeve kompetente, i drejton një kërkesë një vendi tjetër ku dyshohet se pasuria kulturore ka dalë në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke identifikuar poseduesin e saj. Kërkesa duhet të përbajë informacionin e hollësishëm të përshkrimit të pasurisë kulturore dhe çdo informacioni tjetër për të lehtësuar kërkimin si dhe vendndodhjen aktuale apo të dyshuar të pasurisë kulturore të kërkuar.
- Në të njëjtën mënyrë, Republika e Shqipërisë do të informojë një vend tjetër kur një pasuri kulturore e atij vendi gjendet në territorin e saj dhe kur ka dyshim të arsyeshëm të besohet se kjo pasuri kulturore është vjedhur, trafikuar ose importuar në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Baza e të dhënavë të pasurive kulturore të vjedhura, do të ndërveprojë me baza të ngjashme të të dhënavë nga vendet e tjera ose organizatat ndërkombëtare të zbatimit të ligjit, bazuar në një mandat të qartë ligjor, në një mënyrë të automatizuar për të shkëmbyer informacionin primar me ta.

## VII. FAZAT E MENAXHIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

- Procesi i menaxhimit të bazës së të dhënavë nga IKRTK, ndahet në aktivitetet kryesore të mëposhtme, për sa i përket fazës së furnizimit me informacion të tij:
  - Marrja e komunikimeve;
  - Verifikimi i përbajtjes së komunikimeve në lidhje me qëllimet e përcaktuara në Kreun III të këtij udhëzimi;
  - regjistrimi i të dhënavë pas miratimit nga IKRTK;
  - komunikimi që të dhënat nuk janë në përputhje me qëllimet e parashikuara;
  - konsultimi nga/me subjektet e autorizuara.
- IKRTK, pas marrjes së të dhënavë, verifikon nëse ato janë plotësuar sipas mënyrës së përcaktuar në VKM nr. 583/2021 dhe këtij udhëzimi. Nëse nga verifikimi rezulton se të dhënat e plotësuara janë në përputhje me dispozitat e VKM-së nr.583/2021 “Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënavë të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë” dhe këtij udhëzimi atëherë IKRTK i miraton ato brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së të dhënavë. Nëse nga verifikimi rezulton se të dhënat nuk janë plotësuar si duhet nga ana e dhënësve të informacionit sipas dispozitave të VKM-së nr. 583/2021 “Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënavë të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë”dhe këtij udhëzimi, atëherë IKRTK nuk i miraton këto të dhëna pa u plotësuar më parë mangësitë teknike apo ato përshkruese. IKRTK ka detyrim të njoftojë menjëherë dhënësit e informacionit për mungesën apo mangësive në plotësimin e të dhënavë. Dhënësit e informacionit duhet të plotësojnë mangësitë e identifikuara nga IKRTK brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës.

## VIII. STRUKTURA E PËRGJITHSHME E BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Baza e të dhënave është e ndarë në fusha të ndryshme tematike, për shkak të funksioneve të ndryshme që ajo kryen, të cilat korrespondojnë me të njëjtin numër detyrrash të kryera nga personeli përgjegjës për furnizimin e të dhënave dhe konsultimin që synon verifikimin e pasurisë, pavarësisht nëse është vjedhur ose jo:
  - a) **“Regjistrimi i të Dhënave”** kushtuar krijimit të “ngjarjes”, të lidhur me pasurinë kulturore me të cilën shoqërohet emri i pronarit/ve të ligjshëm të pasurisë kulturore
  - b) **“Kërkim/Konsultim”** kushtuar kërkimit të të dhënave aktuale, si dhe krahasimit të imazheve të pasurisë kulturore të cilat gjenden në bazën e të dhënave me ato që duhen verifikuar në bazë të raporteve të gjeneruara nga institucionet përgjegjëse (Policia e Shtetit, Zyrat doganore dhe/ose agjenci të tjera ligjzbatuese, të cilat kanë qasje të plotë në Bazën e të dhënave) ose të paraqitura nga individë privatë duke plotësuar më parë formularin e kërkesës për verifikimin privat sipas Shtojcës “C” të VKM nr. 583/2021 “Për procedurat për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura, të hyra ose të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i Republikës së Shqipërisë”;
  - c) **“Statistikat”** kushtuar analizës, studimit dhe kërkimit të “ngjarjeve” të krijuara, referuar në pikën a të këtij nenit, të ndarë sipas periudhës kohore (p.sh. krahasimi sipas vitit/muajit) dhe referuar në të gjithë territorin kombëtar ose sipas zonës gjeografike (Prefektura, komuna, njësia administrative etj);
  - d) **“Administrimi”** kushtuar menaxhimit teknik të sistemit të informacionit të bazës së të dhënave.

## IX. SISTEMI I REGJISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE PËRDITËSIMI I TYRE

1. Në fushën tematike “Regjistrimi i të Dhënave”, duhet të regjistrohet informacioni në lidhje me furnizimin/përditësimin e “ngjarjes” për:
  - a) “Pasurinë kulturore” të përcaktuar sipas neneve 50 dhe 51 të Ligjit 27 / 2018, për t'u kontrolluar (furnizimi i informacionit);
  - b) Refuzimet për lëshimin e licencës së qarkullimit të lirë, në përputhje me dispozitat e nenit 125 të Ligjit 27/2018 (furnizimi i informacionit);
  - c) Rikuperimi/vendndodhja/sekuestrimi i pasurisë kulturore, sipas pikës “a”, të vjedhur në rast të zbulimit (përditësimit) të tyre vijues;
  - d) Fakte të tjera si:
    - i. Zbulimi i gërmimeve të paligjshme;
    - ii. Dëmtimi i pasurisë kulturore të paluajtshme (monumenteve, ndërtesave historike), qoftë nga njeriu ose si rezultat i katastrofave natyrore;
  - e) Gjenerimi dhe përditësimi i të dhënave mbi vendet dhe njerëzit që kanë lidhje me ngjarjen (përfshirja e të cilëve është thelbësore për krijimin e ngjarjes).

2. Pas raportimit/furnizimit me informacion mbi vjedhjen e pasurisë kulturore të Republikës së Shqipërisë së hyrë/dalë në mënyrë të paligjshme, operatori i bazës së të dhënave do të:

- a) Kontrollojë fillimi shtë pasuria kulturore duhet të kërkohet dhe më pas të sigurohet nëse ngjarja është e regjistruar në Bazën e të dhënave. Nëse jo, të krijuhet një “ngjarje e re” e cila përmban të dhënat e mëposhtme:
  - i. Llojin e veprës penale të kryer (vjedhje, grabitje, mashtrim, përvetësim nga jakat e bardha, dalje/eksport apo hyrje/import e paligjshëm, etj.) ose nëse është një pasurisë kulturore e humbur (e cila ka dalë p.sh. si rezultat i inventarit);
  - ii. Periudha kohore (data/fillimi dhe data/mbarimi, nëse dihet) e kryerjes së veprës penale ose humbjes së pasurisë kulturore;
  - iii. Raporti përkatës/të dhënat e raportit;
  - iv. Zyra e Raportimit (Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Policia, Zyra doganore etj );
  - v. Data e dorëzimit;
- b) Protokolli kompjuterik (nëse raporti është regjistruar në bazën e të dhënave të Policisë së Shtetit);
  - a. Vendndodhja e ngjarjes (Muze, galeri artesh, dyqan antikesh, shtëpi private, vend adhurimi, etj);
  - b. Personi fizik zakonisht i njëjtë me paditësin: kontrollohet nëse të dhënat mbi personin janë apo jo në bazën e të dhënave. Nëse jo, gjenerohet një “person i ri fizik” duke vendosur të dhënat personale emrin, mbiemrin, vendin dhe datën e lindjes, numrin e kartës së identitetit, adresën e vendbanimit dhe kontaktet personale (numër telefoni dhe adresë emaili);
  - c. Dokumentet: Komunikimi i Zyrës që raporton, kthehet në *formatin PDF* dhe ngarkohet në sistemin e informacionit;
  - d. Për identifikimin e saktë të pasurisë kulturore dhe kompjuterizimin duhet të plotësohen të dhënat e mëposhtme:
    - i. *Sasia* (zakonisht korrespondon me 1 sepse pasuritë kulturore duhet të regjistrohen një nga një);
    - ii. *Konteksti i veprës artistike* (Paleontologjike, arkeologjike, antike, moderne, bashkëkohore);
    - iii. *Lloji i objektit* (Përshkrimi i shkurtër i asaj se çfarë është objekti në fjalë. Ky informacion mund të sigurohet nga një fjalë e vetme. Shembuj: ikonë, pikturë, kupë, libër, statujë, shpatë, vazo, unazë,

- grafikë, gjetje arkeologjike, dokument, dorëshkrim arkivor, krijim i kabinetit, etj.) dhe Subjekti (specifikoni objektin/ subjektin e saktë të përfaqësuar nga pasuria kulturore);
- iv. *Materiali* (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë, etj.);
- v. *Teknika e ekzekutimit* (vaj, bojë tempera, pastel, mozaik, serigrafi, litografi, mënyra të përziera, me relief të lartë, basoreliev, gdhendje me daltë, gdhendje në relief, zbukurime me disa materiale (inlay), etj.)
- vi. *Përmasat:* (Lartësia: \_\_\_\_ cm; Bazë: \_\_\_\_ cm; Thellësia: \_\_\_\_ cm; Diametri: \_\_\_\_; Pesa në \_\_\_\_ kg). Në rastin e formave komplekse ose të pazakonta, tregoni matjet në këtë renditje: lartësia x gjerësia, x thellësia;
- vii. *Formati:* specifikoni nëse forma është: horizontale, vertikale, të rrumbullakëta, ovale ose të tjera;
- viii. *Autori* (nëse dihet shkruani “nënshkruar nga ...”, ose “atribuohet për ...”, ose “Shkolla e ...”, koha e ekzekutimit - tregoni shekullin dhe, nëse dihet, vitin); Informacion që përcakton origjinën e ekzistencës materiale të veprës artistike: identitetin e artistit; koha kur artisti krioi veprën artistike ose kur u prodhua objekti antik; dhe në fund vendi ku u krijuar. Ky informacion përcakton origjinën e objektit dhe origjinalitetin e tij. Nëse veprat janë produkte bashkëpunimi ose kopje, tregoni artistët ose artistin e kopjuar, nëse dihet. Nëse vepra i atribuohet vetëm një artisti të vetëm, shkruani “I atribuohet [...].” Në rastin e materialeve të shtypura, shënoni emrin e botuesit, vendin dhe vitin e botimit.
- ix. *Koleksion:* Konsiderohet si një koleksion një grup objektesh, punimesh ose dokumentesh të ndryshme që formojnë një unitet kulturor dhe që nuk mund të shkëputen pa dëmtuar koherencën e tij, dhe për të cilat vlera e kombinuar është më e madhe se shuma e vlerave individuale të elementeve përbërës të tij. Së bashku me identifikimin dhe vlerësimin e nevojshëm të secilit prej përbërësve të tij, jepni një arsyetim që prona të trajtohet si një koleksion.
- x. *Titulli i veprës artistike* (nëse dihet). Ndonjëherë objekti nuk do të ketë titull zyrtar, por është bërë i njojur me një emër specifik. Kur kjo nuk përfshihet në formulimin e titullit, “subjekti” e përshkruan atë që objekti kulturor synon të përfaqësojë. Shembuj: Portret; Figurë në këmbë e një njeriu; prapaskena e jashtme me një qen; Peizazhi me anije etj;
- xi. *Përshkrimi përbledhës i pasurisë kulturore;*
- xii. *Fotografi:* Fotografia me ngjyra (të paktën 9 × 12 cm). Për të lehtësuar identifikimin e objekteve tredimensionale, mund të kërkohen pamje të ndryshme të pasurisë kulturore (ballore, anësore dhe nga prapa). IKRTK mund të kërkojë fotografi të tjera shtesë;

- xiii. *Informacione të tjera* (katalogimi/ numri i inventarit, vlera, mbulimi nga sigurimi, referanca e bazës së të dhënave të INTERPOL, publikimi i mundshëm në një faqe të jashtme në internet për publikun, etj.).
- b) Plotësimi i të dhënave mbi refuzimet për të lëshuar licencën e qarkullimit të lirë ose të përkohshëm, sipas Ligjit nr.27/2018 (furnizimi i informacionit) që gjeneron një “ngjarje të re”. “Ngjarja e re” përmban të dhënrat e mëposhtme:
- i. Numrin e protokollit, datën e lëshimit dhe zyrën që ka lëshuar refuzimin;
  - ii. Datën e dorëzimit (dhe numri i protokollit në mbërritje, nëse ka) të kërkesës për licencë qarkullimi të lirë;
  - iii. Datën e revokimit të numrit të refuzimit/ protokollit, nëse ka, dhe tregues për Zyrën e cila ka revokuar vendimin;
  - iv. Vendin e ngjarjes (korrespondon me vendin ku ndodhet pasuria kulturore në momentin e paraqitjes së kërkesës);
  - v. Personin fizik (zakonisht i njëjtë me aplikantin/ pronarin ose me ndonjë ndërmjetës: kontrolloni nëse personi është apo jo i pranishëm në bazën e të dhënave, nëse jo, gjenerohet një “person i ri fizik”) duke vendlindjen, mbiemrin, vendlindjen dhe datën e lindjes, adresën e vendbanimit dhe kontaktet personale (numër telefoni dhe adresë elektronike/emaili);
  - vi. Dokumentet: komunikimi i Zyrës së raportimit kthehet në *formatin pdf* dhe futet në sistemin e informacionit;
  - vii. Pasurinë kulturore, për identifikimin e saktë duhet të plotësohen të dhënat e mëposhtme:
    - a. *Sasia* (zakonisht korrespondon me 1 sepse pasuritë kulturore duhet të regjistrohen një nga një);
    - b. *Konteksti i veprës artistike* (Paleontologjike, arkeologjike, antike, moderne, bashkëkohore);
    - c. *Lloji i objektit* (Përshkrimi i shkurtër i asaj se çfarë është objekti në fjalë. Ky informacion mund të sigurohet nga një fjalë e vetme. Shembuj: Ikonë, Pikturë; Kupë; Libër; Statujë; Shpatë; Vazo; Unazë, grafikë, gjete arkeologjike, dokument, dorëshkrim arkivor, krijim i kabinetit, etj.) dhe Subjekti (specifikonit objektin/ subjektin e saktë të përfaqësuar nga pasuria kulturore);
    - d. *Materiali* (letër, dru, kanavacë, lloj metali, qelq, gur, pëlhurë, etj.);
    - e. *Teknika e ekzekutimit* (vaj, bojë tempera, pastel, mozaik, serigrafi, litografi, mënyra të përziera, me relief të lartë, basoreliev, gdhendje me daltë, gdhendje në relief, zbukurime me disa materiale (inlay), etj.)
    - f. *Përmasat:* (Lartësia: \_\_\_\_ cm; Bazë: \_\_\_\_ cm; Thellësia: \_\_\_\_ cm; Diametri: \_\_\_\_; Pesa në \_\_\_\_ kg). Në rastin e formave komplekse ose të pazakonta, tregoni matjet në këtë renditje: lartësia x gjerësia, x thellësia;
    - g. *Formati:* specifikoni nëse forma është: horizontale, vertikale, të rrumbullakëta, ovale ose të tjera;

- h. *Autori* (nëse dihet shkruani “nënshkruar nga ...”, ose “atribuohet për ...”, ose “Shkolla e ...”, koha e ekzekutimit - tregoni shekullin dhe, nëse dihet, vitin); Informacion që përcakton origjinën e ekzistencës materiale të veprës artistike: identitetin e artistit; koha kur artisti krijoi veprën artistike ose kur u prodhua objekti antik; dhe në fund vendi ku u krijua. Ky informacion përcakton origjinën e objektit dhe origjinalitetin e tij. Nëse veprat janë produkte bashkëpunimi ose kopje, tregoni artistët ose artistin e kopjuar, nëse dihet. Nëse vepra i atribuohet vetëm një artisti të vetëm, shkruani “I atribuohet [...].” Në rastin e materialeve të shtypura, shënoni emrin e botuesit, vendin dhe vitin e botimit.
  - i. *Koleksion*: Konsiderohet si një koleksion një grup objektesh, punimesh ose dokumentesh të ndryshme që formojnë një unitet kulturor dhe që nuk mund të shkëputen pa dëmtuar koherencën e tij, dhe për të cilat vlera e kombinuar është më e madhe se shuma e vlerave individuale të elementeve përbërës të tij. Së bashku me identifikimin dhe vlerësimin e nevojshëm të secilit prej përbërësve të tij, jepni një arsyetim që prona të trajtohet si një koleksion.
  - j. *Titulli i veprës artistike* (nëse dihet). Ndonjëherë objekti nuk do të ketë titull zyrtar, por është bërë i njojur me një emër specifik. Kur kjo nuk përfshihet në formulimin e titullit, "subjekti" e përshkruan atë që objekti kulturor synon të përfaqësojë. Shembuj: Portret; Figurë në këmbë e një njeriu; prapaskena e jashtme me një qen; Peizazhi me anije etj;
  - k. *Përshkrimi përmbledhës i pasurisë kulturore*;
  - l. *Fotografi*: Fotografia me ngjyra (të paktën  $9 \times 12$  cm). Për të lehtësuar identifikimin e objekteve tredimensionale, mund të kërkohen pamje të ndryshme të pasurisë kulturore (ballore, anësore dhe nga prapa). IKRTK mund të kërkojë fotografi të tjera shtesë;
  - m. *Shënimë* (fusha me tekst të lirë për të vendosur informacione të vlefshme me interes).
- c) Në rastin e rikuperimit/ vendndodhjes/ konfiskimit të pasurive kulturore, në varësi të kërkimit të përmendorur në pikën “a”, përditësohet sistemi kompjuterik duke kontrolluar paraprakisht nëse pasuritë janë të pranishme apo jo në bazën e të dhënave. Nëse pasuritë kulturore nuk janë në Bazën e të Dhënave, duhet të krijohet një “ngjarje e re” në mënyrë që të mund të vendoset ngjarja “rikuperim/ vendndodhje/ konfiskim”. Sapo të jenë identifikuar pasuritë kulturore për t'u rikuperuar, operatori duhet të regjistrojë:
  - i. Datën e rikuperimit;
  - ii. Vendin e rikuperimit;
  - iii. Zyrën përgjegjëse që e ka proceduar këtë rast;
  - iv. Përllogaritjen e vlerës së pasurisë kulturore (nëse ka);
  - v. Shënimë (fusha me tekst të lirë për informacione me interes).
- d) Në rast të fakteve të tjera si p.sh.:

- i. zbulohen gërmime të paligjshme (nuk janë të autorizuara në përputhje me pikën 8, të nenit 133 të Ligjit nr.27/2018), duhet të gjenerohet një “ngjarje e re”, në të cilën duhet të vendosen të dhënat e mëposhtme:
  - a. Lloji i ngjarjes (ngjarje të tjera);
  - b. Kategoria e ngjarjes (gërmime të paligjshme);
  - c. Lloji i shkeljes (administrative lidhur me kërkimet dhe zbulimet e artefakteve arkeologjike, në përputhje me pikën “a” të nenit 260 të Ligjit nr.27/2018);
  - d. Data e ngjarjes (lidhur me zbulimin);
  - e. Vendi i ngjarjes (identifikoni bashkinë dhe njësinë administrative dhe emrin e zonës arkeologjike);
  - f. Zyra e Raportimit (Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Policia e Shtetit etj.);
  - g. Shënimë (fusha me tekst të lirë për informacion me interes, siç mund të jenë të dhënat mbi koordinatat gjeografike të vendndodhjes së saktë të gërmimeve të paligjshme);
  - h. Instrumente kërkimore arkeologjike të sekuestruara (tregoni llojin dhe sasinë e instrumenteve të sekuestruara);
  - i. Dokumentet: komunikimi i Zyrës së raportimit kthehet në formatin pdf dhe ngarkohet në sistemin e informacionit;
  - j. Trashëgimia kulturore: vetëm në rast të zbulimit të objekteve kulturore ose fragmenteve të tyre, procedohet me vendosjen;
- ii. Dëmtimi i trashëgimisë kulturore të paluajtshme (monumente, ndërtesa historike), qoftë nga njeriu ose si rezultat i katastrofave natyrore - gjenerohet një “ngjarje e re”, në të cilën vendosen të dhënat e mëposhtme:
  - a. Lloji i ngjarjes (ngjarje të tjera);
  - b. Kategoria e ngjarjes (dëmtimi nga njeriu/ shkaqet natyrore);
  - c. Lloji i shkeljes (specifikoni nëse përbën vepër penale);
  - d. Data e ngjarjes (lidhur me ngjarjen);
  - e. Vendi i ngjarjes (specifikoni bashkinë, njësinë administrative dhe vendin: p.sh. kisha, monumenti, muzeu, ndërtesa historike, etj.);
  - f. Zyra e Raportimit (Drejtori të Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Policia e Shtetit, etj.);
  - g. Shënimë (fusha me tekst të lirë për informacione me interes);
  - h. Dokumentet: komunikimi i Zyrës së raportimit kthehet në *formatin pdf* dhe ngarkohet në sistemin e informacionit;
  - i. Pasuri kulturore: Specifikoni vetëm nëse dëmtohen ato pasuri të vendosura brenda strukturës (p.sh. piktura, skulptura brenda muzeut).

## X . SISTEMI I KËRKIMEVE DHE KONSULTIMIT TË BAZËS SË TË DHËNAVE

1. Fusha tematike “Kërkim/Konsultim” i kushtohet kërkimit të të dhënavë të pranishme, si dhe krahasimit (automatik dhe manual) të imazheve (nëse ka) të pasurisë kulturore në Bazën e të Dhënavë me ato që do të verifikohen në bazë të raporteve (shoqëruar me fotografji, të institucioneve publike (Policia, Doganat, Drejtoria Rajonale e

- Trashëgimisë Kulturore, etj.) ose të paraqitura nga individë privatë përmes plotësimit të formularit të kërkesës, është strukturuar duke respektuar të njëjtat fusha të përdorura te “Regjistrimi i të Dhënave”, referuar Kreut IX.
2. Operatori mund të përdorë fushën e kërkimit “tekst i lirë”, i cili i lejon të ketë një gamë të gjerë rezultatesh.

## XI. STATISTIKAT DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Zona tematike “Statistika” i kushtohet përpunimit dhe analizimit të të dhënave të mbledhura në bazë të përcaktimit të një periudhe kohore (data e fillimit dhe e mbarimit) dhe një zone të përcaktuar gjeografike që përzgjidhet lirisht nga operatori, në lidhje me vjedhjen, humbjen e pasurisë pas inventarit dhe gërmimeve të paligjshme.

## XII. ADMINISTRATA

Fusha tematike “Administrata” i kushtohet nivelit më të lartë të menaxhimit të bazës së të dhënave nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, e ushtruar nga IKRTK. Në lidhje me këtë funksion, titullari i institucionit:

- Menaxhon drejtpërdrejt profilet e hyrjes së përdoruesve në sistem, duke dhënë autorizimin për t'u konsultuar dhe/ose gjeneruar “ngjarje të re” (me funksionin “Regjistrimi i të Dhënave”) te Baza e të Dhënave, ose revokimin e saj në lidhje me nevojat e ndryshuara të shërbimit konfidencialiteti i të dhënave të përbajtura;
- Autorizon përdoruesit të gjenerojnë/ fshijnë fusha të reja për vendosjen/ modifikimin e “regjistrave me tabela” të vendeve të reja, zyrave, autorëve të trashëgimisë kulturore (e cila ndodh kur është e nevojshme për të vendosur një bashki/ zyrë të re që nuk ndodhet në bazën e të dhënave, ose një “autor të ri” të veprave artistike);
- Siguron hartimin e një “Buletini Periodik të veprave të vjedhura të artit”, midis atyre që konsiderohen se meritojnë më shumë vëmendje përsa i përket rëndësisë së tyre, të cilat mund të zbulohen në format e gjykuara si më të përshtatshme nga IKRTK;
- Autorizon transmetimin e të dhënave në lidhje me veprat e artit të cilat duhet të kërkohen në bazën e të dhënave të INTERPOL-it.

## RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN E PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA

## XIII. RIKUPERIMI I PASURIVE KULTURORE TË VJEDHURA

- Një objekt i pasurisë kulturore, i cili është përfshirë në bazën e të dhënave mund të rikuperohet përmes dorëzimit vullnetar nga ana e subjekteve që posedojnë pasuri të përfshira në bazën e të dhënave, te Policia e Shtetit. Kjo e fundit, informon menjëherë IKRTK për këtë dorëzim vullnetar të pasurisë kulturore.
- Në këtë rast, pasi të jenë verifikuar dhe regjistruar paraprakisht, rrethanat e blerjes së pasurisë kulturore të vjedhur nga personi që e dorëzon atë, si dhe informacione të tjera

që vlerësohen të dobishme për procesin e verifikimit dhe konstatimit të fakteve, të cilat do t'i raportohen më pas autoriteteteve përgjegjëse gjyqësore, oficeri i policisë ose një zyrtar tjetër i agjencive ligjzbatuese merr hapat e mëposhtme:

- a) Nëse dorëzimi bëhet brenda 3(tre) vjetësh nga botimi/regjistrimi i pasurisë kulturore në Bazën e të Dhënave, oficeri i policisë apo ndonjë zyrtar tjetër i agjencive ligjzbatuese harton një raport për dorëzimin vullnetar të pasurisë kulturore, me identifikimin e personit që e ka dhënë atë por pa i komunikuar të dhënat personale të tij, IKRTK-së;
  - b) Informon menjëherë IKRTK në mënyrë që të mund të kryejë një kontroll të bazës së të dhënave për të parë nëse objekti kulturor është në kërkim apo jo;  
Nëse lindin dyshime të arsyeshme për origjinën e paligjshme të pasurisë kulturore të dorëzuar, kryejnë çdo veprim të nevojshëm që synon identifikimin e pronarit apo përfaqësuesit të tij ligjor apo dhe poseduesit të ligjshëm për ndonjë arsy;
3. Në rast se pasuria e rikuperuar kulturore identifikohet në Bazën e të dhënave, IKRTK e heq atë nga kjo Bazë të dhëna dha punon së bashku me agjencitë e zbatimit të ligjit për të identifikuar pronarin apo përfaqësuesin e tij ligjor dhe shtetin e tij (kur është e mundur).
- a) Nëse identifikohet pronari apo përfaqësuesi i tij ligjor të cilit i përket pasuria kulturore dhe shteti, IKRTK, në bashkëpunim me autoritetet e atij shteti, bazuar në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, nëse ka, merr masat për kthimin sa më të shpejtë të pasurisë kulturore tek pronari apo përfaqësuesi i tij ligjor.

#### XIV. MASAT PËR RUAJTJEN DHE KUJDESIN E PASURISË KULTURORE

1. IKRTK në bashkëpunim me institucionet e tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore informon Policinë e Shtetit dhe Plikat Doganore Kufitare të cilat kanë në ruajtje pasurinë kulturore të sekuestruar, mbi të gjitha masat që synojnë ruajtjen e pasurisë kulturore të sekuestruar sipas llojit të pasurisë kulturore dhe referuar legjislacionit në fuqi për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ku ndër më të rëndësishmet janë si më poshtë:
  - a) Në çdo rast, duhen marrë masa për mënjanimin apo eliminimin e shkaqeve që shkaktojnë degradimin e materialeve nga të cilat përbëhet pasuria kulturore;
  - b) Pasuria kulturore duhet të vendoset në një dhomë të përshtatshme për ruajtjen e e saj duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm mjesdisor:
    - i. mosekspozim ndaj rrezatimit diellor;
    - ii. mosekspozim ndaj pluhurit të imët dhe ose agjentëve të tjerë kimikë;
    - iii. temperatura e ajrit të jetë ndërmjet  $15^{\circ}$  dhe  $20^{\circ}$  C;
    - iv. niveli i lagështirës të jetë ndërmjet 40% dhe 55% (të merret parasysh rast pas rasti në lidhje me kushtet klimatike të vendit të magazinimit dhe në lidhje me llojin e pasurisë kulturore që ruhet);
    - v. mosekspozim ndaj shtypjes së tepërt mekanike dhe ose mbrojtjes nga rreziku i rënies aksidentale të pasurisë kulturore në ruajtje dhe ose të objekteve të tjera mbi të.

- c) ruajtjen e pasurive kulturore në një vend i cili mbrohet me sisteme të përshtatshme kundër zjarrit dhe me kamera, si dhe ku aksesi për publikun është i ndaluar ndërsa aksesi për personelin që punon to është i kufizuar në pak njerëz, hyrja e të cilëve në çdo rast duhet të jetë e monitoruar;
  - d) Regjistrimin e të dhënave kryesore të pasurive kulturore në një regjistër të veçantë, të cilat janë nën kujdes, si dhe rregjistrimin e të dhënave personale të personit që i ka dorëzuar ose nga i cili është sekuestruar, datën, orën dhe vendin e dorëzimit të tij.
2. Në rastet kur është e pamundur që pasuria kulturore e rikuperuar të ruhet duke respektuar kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij kreu, Policia e Shtetit, Zyrat Doganore ose agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit që mbajnë përkohësisht pasurinë në fjalë, në bashkëpunim me IKRTK dhe ose institucionet e tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore, duhet të identifikojnë një mjeshtëri përshtatshëm për ruajtjen e saj siç janë muzetë, bibliotekat, institucionet e tjera të specializuara të trashëgimisë kulturore, ku pasuria kulturore të transportohet, me kujdesin e nevojshëm dhe duke respektuar teknikat e specializuara të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me qëllim parandalimin e dëmtimit të pasurisë kulturore.

## XV. KTHIMI I PASURISË KULTURORE

1. Pasi autoriteti gjyqësor ka marrë vendimin e kthimit të pasurisë kulturore tek pronari i ligjshëm apo përfaqësuesit e tij dhe pasi nga ana e pronarit të ligjshëm apo përfaqësuesit është njohur zyrtarisht pronësia e pasurisë kulturore, objekt i shqyrtimit gjyqësor, operatori kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) harton raportin përkatës;
  - b) përditëson regjistrin e pasurive kulturore që ndodhen nën kujdes, në përputhje me detyrimet e përcaktuara sipas pikës 1, shkronja "d" të kreut XIV të këtij udhëzimi;
  - c) informon IKRTK-në për kthimin e pasurisë kulturore, e cila duhet të miratojë të gjitha ndryshimet në bazën e të dhënave.

## XVI. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, IKRTK, dhe Drejtori i Rajonale të Trashëgimisë Kulturore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

ELVA MARGARITI

